



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 38, datë 23.07.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN E KONFISAKUAR:
“HOTEL 1 DHE 6 KATE, ME 2 KAT NËNTOKË, NË FUNKSION TË ZYRAVE TË
AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS” ME VENDODHJE NË RRUGËN
“QAMIL GURANJAKU”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të nenit 27, gërmës (ç) të pikës 1 të 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Nenit 27 të Ligjit Nr. 66/2023 “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara”, akteve nënligjore në zbatim të saj, gërmës (c) të pikës 3 të Nenit 19 të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 6, datë 18.06.2025 të Komisionit të Objekteve të Konfiskuara, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin e konfiskuar: “Hotel 1 dhe 6 kate, me 2 kat nëntokë, në funksion të zyrave të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës ” me vendndodhje në rrugën “Qamil Guranjaku”, Bashkia Tiranë, me zhvillues Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit .
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Procedura administrative për shqyrtimin e aplikimit për leje ndërtimi si dhe lëshimi i çertifikatës së përdorimit për objektin e përshkruar në pikën 1 të këtij vendimi, do të vijohet nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, si Sekretariat Teknik i KKTU-së.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHA



ANËTAR/SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 28/07/2025